



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KRYEMINISTRI**

**U R D H Ë R**

**Nr.103, datë 7.8.2020**

**“PËR**

**NGRITJEN E KOMISIONIT TË VEÇANTË PËR VLERËSIMIN E**  
**REZULTATEVE TË STUDENTËVE, TË CILËT STUDIOJNË JASHTË**  
**VENDIT, DHE SHTETASVE TË HUAJ ME ORIGJINË SHQIPTARE, TË**  
**CILËT PËRFITOJNË BURSA STUDIMI NGA REPUBLIKA E**  
**SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, dhe në vijim të pikës 7, të vendimit nr. 504, datë 24.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e bazës të të dhënave shtetërore të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa nga Republika e Shqipërisë”,

**U R D H Ë R O J:**

1. Ngritjen e komisionit të veçantë për vlerësimin e rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë (në vijim Komisioni).
2. Komisioni të kryesohet nga ministri përgjegjës për diasporën dhe në përbërje të ketë këta anëtarë:
  - a. Zëvendësministrin e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - b. Zëvendësministrin për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - c. Sekretarin e Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - d. Sekretarin e Përgjithshëm në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - e. Drejtorin e Agjencisë Kombëtare të Diasporës;



- f. Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
  - g. Drejtorin e Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Politike dhe Strategjike në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme;
  - h. Drejtorin e Drejtorisë së Çështjeve Konsullore në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
3. Për vlerësimin e rezultateve të studentëve, të cilët studiojnë jashtë vendit, dhe shtetasve të huaj me origjinë shqiptare, të cilët përfitojnë bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, Komisioni bazohet në informacionin për studentët, shtetas të Republikës së Shqipërisë të cilët studiojnë jashtë vendit dhe për studentët, shtetas të huaj me origjinë shqiptare, të cilët kanë përfituar bursa studimi nga Republika e Shqipërisë, në shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga Agjencia Kombëtare e Diasporës, si dhe në çdo informacion tjetër që vlerësohet i nevojshëm nga Komisioni.
  4. Komisioni realizon një raport vjetor për Komitetin Shtetëror të Diasporës dhe Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin, në Kuvendin e Shqipërisë.
  5. Komisioni mbledhet të paktën 3 (tre) herë në vit ose jashtë radhës me kërkesën e kryetarit të tij.
  6. Institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, të caktojnë përfaqësuesit e tyre në këtë komision brenda 7 (shtatë) ditësh nga hyrja në fuqi e tij.
  7. Ngarkohen komisioni dhe institucionet e përmendura në pikën 2, të këtij urdhri, për zbatimin e tij.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**